

E dielë, 17 nëntor 2019
Nga: Jelena Popadić

Rajoni nuk mund të presë përgjithmonë në rradhë për në BE

Vendimi për të mos hapur negociatat mund ta përkeqësojë situatën.

Strategjia e re e BE-së për zgjerimin duhet të jetë një strategji e guximshme, e qartë, koherente, e cila shmang paqartësitë, deklaroi për *Politika*-n Majlinda Bregu, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Ajo theksoi se Ballkani Perëndimor nuk mund të qëndrojë përgjithmonë në rradhën e pritjes për anëtarësim në BE, duke bërë ndërkohë gjëra të vogla. Bregu, e cila pasoi Goran Svilanović në këtë pozicion, shton se BE-ja po përballlet me shumë sfida dhe mospërputhje lidhur me zgjerimin. Ballkani Perëndimor, siç thotë ajo, po jeton çdo ditë mes paqartësive, megjithëse për disa vjet tashmë është dëshmitar se perspektiva e pranimit nuk po i afrohet më shumë realitetit.

Ish Ministria e Integritimit Evropian e Shqipërisë (2007-2013) dhe Deputete në Kuvendin e Shqipërisë (2005-2017), i tha Politika-s se sa herë që reja e BE-së nuk është në kulmin e vet, aq më shumë të dukshme bëhen problemet. Që prej marrjes së detyrës në fillim të këtij viti ajo ka qenë mbështetëse e fortë e ndërlidhjes rajonale, megjithëse e vetëdijshme se kjo nuk është detyrë e lehtë.

Ndërlidhja është ende problem i madh në rajon, papunësia është e lartë, rrjedhja e trurit është shqetësuese, ka sfida që lidhen me sigurinë, mosmarrëveshje bilaterale. A duhet vërtet t'i themi vetes se ky rajon është shtëpia jonë?

Unë besoj se ka ardhur koha të përqendrohemi se si t'i lidhim më mirë njerëzit dhe ekonomitë tona, duke mbajtur parasysh perspektivën e përqendruar te njerëzit, krijimin e lidhjeve më të mira midis ekonomive të rajonit në dobi të qytetarëve, dhe duke u përpjekur të punojmë pak më shumë edhe me reformat e brendshme, në vend që të jemi të fiksuar me datat ose metodologjitë e reja që do të na prezantohen.

Sipas mendimit tuaj, cila duhet të jetë qasja e re e zgjerimit e BE-së?

Le të presim së pari që të formulohet qasja e re për zgjerimin e BE-së. Ballkani Perëndimor nuk ishte në listën e përparësive për disa shtete anëtare të BE-së, por për Ballkanin Perëndimor mendoj se përparësia duhet të jetë që të përfshihet në hartimin e metodologjisë së re. Sido që të jetë qasja e re, metodologjia e re, realiteti i ri, pavarësisht emrit, **vendimi për të duhet të merret së bashku me të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor**. Në kohë paqartësie dhe kryesisht në këto kohë, strategjia e re e BE-së për

zgjerimin duhet të jetë një strategji e guximshme, e qartë, koherente, duke shmangur paqartësitë, një metodologji që mund të krijojë lidhje më të mira midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor edhe përpara anëtarësimit, pa premtime boshe, dhe padyshim një metodologji që mund të fuqizojë ekonominë në rajon për të përmbushur reformat.

Kur keni folur për këtë, jeni shprehur se “dëmi gjeografik” në rajon duhet të shmanget. Çfarë keni dashur të thoni me këtë?

Vendimi për të mos hapur negociatat e anëtarësimit mund ta përkeqësojë situatën. Një situatë e keqe zakonisht përkeqësohet edhe më tepër kur ajo nuk trajtohet siç duhet. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se ka forca negative që mund të punojnë kundër reformave në rajon - dhe me këtë nuk dua të them vetëm aktorë të tretë, por dua të them që dëmtimi gjeopolitik në rajon mund të vijë nga paqëndrueshmëria politike, e cila përbën një rrezik real. Ballkani Perëndimor është një rajon që është ende një periferi me ndikime konkurruese. E di se dalja e aktorëve jo-perëndimorë nuk është një qasje ekskluzive e rezervuar për BP-në. Është pjesë e një ndryshimi global të interesave në pushtet. Shkurtimisht, plotësimi gjeopolitik në BP nuk është pa rrezik.

A mund të ndodhë, siç përmendet ndonjëherë, që të ketë një “BE paralele” të përbërë nga këto gjashte vende?

BE-ja është modeli për këtë rajon. Nuk mund ta kuptoj se si 6 ekonomi mund të jenë njësoj si 28 ekonomi, por shpresoj që dita kur të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të bëhen shtete anëtare në BE, të mos jetë shekulli tjetër. Uroj që të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të jenë shtete anëtare të BE-së në një të ardhme të parashikueshme. Uroj që të njëjtat standarde të zbatueshme për qytetarët e BE-së të jenë jetësore dhe të domosdoshme në rajonin tonë. Ndërsa ka ende rrugë të gjatë për t'u bërë gati për t'u atarësuar në BE, ne kemi ende një shans për të transformuar ekonominë tona. Pra, sa herë që aplikohet ndonjë qasje ose ndonjë veprim që mund të na afrojë më shumë me modelin e BE-së, do të thotë që do të kemi standarde më të mira në shtëpinë tonë. Nëse kjo rrugë është e qartë, nëse procesi do të jetë transformues për secilën ekonomi, nuk do të duhet të shqetësohemi shumë për datën kur do të bëhemi zyrtarisht shtete anëtare të BE.

Një prej çështjeve shqetësuese për të gjitha vendet e rajonit është migracioni ekonomik; a ka ndonjë mënyrë për të ulur të paktën pasojat?

Nuk kam një formulë magjike. Kjo varet nga politikanët që votohen për të hartuar politikën e duhura, nga ndihma e shoqërisë civile, nga mediat për të qenë serioze për pasqyrimin e realiteteve të shumëanshme në rajon, nga komuniteti i biznesit për të mirëpritur idetë novative dhe teknologjitetë e reja.

Migrimi ekonomik nuk është homogjen, jo të gjithë kanë të njëjtin aftësim dhe për migrantët me aftësi, migracioni mund të jetë më i dobishëm se sa për ata që janë të pakualifikuar.

E di se njerëzit që po largohen nga rajoni, nuk largohen vetëm sepse janë të papunë. Disa prej tyre janë të papunë, disa të tjerë, më të rinj, po largohen sepse dëshirojnë arsimim më

të mirë, i cili mund t'u ofrojë mundësinë për të gjetur një punë nesër, ose në të ardhmen e afërt. Disa të tjerë po largohen sepse nuk ndajnë, le të themi, të njëjtat bindje politike të pranishme në vendet e tyre, kështu që migracioni gjithmonë ka kuptime të ndryshme. Por, lidhur me migracionin ekonomik, unë mendoj se politikat e duhura mund të ndihmojnë secilën ekonomi të rajonit për të angazhuar siç duhet ata që mund të duan të kthehen dhe të investojnë në atdheun e tyre.

Ka konflikte të gjata dhe mosmarrëveshje bilaterale midis disa prej vendeve të rajonit. A është e mundur të kapërcehen të gjitha këto dhe sa të gatshëm janë politikanët të bashkëpunojnë për qëllimin e ofrimit të një jete më të mirë për qytetarët?

Po, ka konflikte dhe mosmarrëveshje të gjata në rajon. Kjo është vetëm një pjesë e realitetit. Disa mosmarrëveshje politike dhe bilaterale mund të përhapen gjatë procesit të bashkëpunimit rajonal.

Ju jeni nga Shqipëria. Frika e nacionalizmit të Shqipërisë së Madhe është e pranishme në Serbi dhe në Republikat e tjera Jugosllave për shkak të deklaratave të Edi Ramës për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Cili është pozicioni juaj për këtë çështje?

Kjo është frikë e pabazuar. Unë nuk do të komentoj mbi deklaratat e Edi Ramës ose të ndonjë lideri tjetër në rajon, por duke qenë se më pyete si shqiptare, unë jam mjaft e sigurt dhe shpresoj që Kosova* dhe Shqipëria të ndajnë vizionin e bashkimit brenda familjes së BE-së. Dhe, nëse kjo rrugë do të jetë e qartë për të gjitha ekonomitë e rajonit, unë mendoj se në të ardhmen e afërt do të kemi një rajon më të madh që do të jetë shumë afër një Evrope më të madhe sa i përket ideve dhe vlerave të duhura.

Lehtësoni bashkëpunimin midis 6 ekonomive të rajonit

Çfarë mendoni për “mini-Shengen-in”? Misioni ynë është të forcojmë bashkëpunimin rajonal. Procesi i pranimit në BE ka qenë i ngadaltë, e thashë edhe më herët. Tani, është edhe më i paqartë dhe i trazuar. Ndërkohë që kemi hasur vështirësi në angazhim dhe në veprim për përmbushjen e agjendave rajonale pjesë të Zonës Rajonale Ekonomike, procesi është jetik si për njerëzit ashtu edhe për biznesin. Një prej detyrave tona është të lehtësojmë bashkëpunimin midis 6 ekonomive të rajonit. Ky koncept qëndron po ashtu edhe në themel të politikës së zgjerimit. Zgjerimi ka të bëjë me lidhjen e tregjeve dhe njerëzve. Çdo iniciativë për të ndihmuar dhe për të zgjidhur pengesat brenda rajonit tone, duhet të merret në konsideratë. Rajoni është një treg i vogël (me vetëm 18 milion banorë) për investitorët e huaj. Ne duhet t'i qëndrojmë në krah njëri-tjetrit.